

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.151/21 prot, datë 09.11.2021, ju informojmë se adresa e email info@qkkf.gov.al nuk ka qënë e menaxhuar nga QKKF deri në datën 18.11.2021, pasi nuk ka qënë aktive si adresë email-i, rrjedhimisht ka qënë e pamundur kthimi i përgjigjeve. Më poshtë po ju përgjigjemi kërkesës tuaj:

Pyetja 1. Sa është numri i shfaqjeve të realizuara gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit 2021 (online dhe fizikisht)?

Përgjigje e pyetjes 1. Për periudhë Janar-Qershor 2021 numri i shfaqjeve online (facebook) është 70 shfaqje dhe në ambiente të hapura 16 shfaqje.

Pyetja 2. Cilët janë titujt e shfaqjeve dhe vendet ku këto shfaqje janë dhënë?

Përgjigje e pyetjes 2. Titujt e shfaqjeve janë: “3 Derrkucët”, “Vitaminat e Jetës”, “Delja e Detit”, “Rosaku i shëmtuar”, “Qullaci i Hekurt”, “Peshku i Artë”, “Na ishte Njëherë”, “Aladini”, “Shtëpia e Embëlsirave”, “E bukura dhe Bisha”, “Kësulëkuqja”, “Dhelpra dhe Lejleku”, “Macoku me Cizme” dhe vendet në të cilat janë zhvilluar shfaqjet janë: skena e Teatrit të Kukullave Tiranë, Pogradec, Ersekë, Këlcyrë, Tepelenë, Lazarat, Dervican, Kukës, Bajram Curr.

Duke nisur nga data 18.11.2021 adresa info@qkkf.gov.al është aktive dhe monitorohet rregullisht nga ora 08:00-16:30 nga e hëna në të premte nga QKKF.

Gjithashti ju bëjmë me dije se QKKF ka nisur procedurën e prokurimit për ndërtimin e websit-it zyrtar qkkf.gov.al nëpërmjet të cilit çdo qytetar do të ketë mundësinë të informohet në kohë reale mbi informacione të ndryshme, përfshirë dhe informacionin që kërkohet në rastin konkret për të cilin është ankuar qytetari.

QKKF do të vërë në dispozicion të gjithë infomacionin që kërkohet në mënyrë digjitale.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,